



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.80, datë 28.06.2021

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.46, DATË 06.04.2012 “PËR
NDRYSHIMIN E VKB-SË NR. 79, DATË 10.05.2006 “PËR MIRATIMIN E
STRUKTRURAVE ORGANIZATIVE DHE RREGULLOREVE TË BRENDSHME TË
FUNKSIONIMIT TË NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË
BASHKISË DURRËS”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse, Ligjit Nr.7582, datë 13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore” i ndryshuar si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të strukturës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale duke hequr nga kjo strukturë, Sektorin e Gjellërimit përbërë nga 100 punonjës.
2. Miratimin e ndryshimit të strukturës së Ndërmarrjes Komunale Plazh duke hequr nga kjo strukturë, Sektorin e Gjellërimit përbërë nga 13 punonjës.

3. Miratimin e ndryshimit të strukturës së Ndërmarrjes Rruga duke shtuar në këtë strukturë, Sektorin e Gjelbërimit, që do të përbëhet gjithsej nga 113 punonjës.
4. Fondet e miratuara për vitin 2021 për Sektorin e Gjelbërimit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe të mbetura të pashpenzuara deri në momentin e transferimit të këtij sektori pranë Ndërmarrjes Rruga, do t'i kalojnë Ndërmarrjes Rruga.
5. Fondet e miratuara për vitin 2021 për Sektorin e Gjelbërimit të Ndërmarrjes Komunale Plazh për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe të mbetura të pashpenzuara deri në momentin e transferimit të këtij sektori pranë Ndërmarrjes Rruga, do t'i kalojnë Ndërmarrjes Rruga.
6. Ngarkohen Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Ndërmarrja Komunale Plazh dhe Ndërmarrja Rruga të ndjekin procedurën e mëtejshme për transferimin e aseteve të këtyre sektorëve sipas legjislacionit në fuqi.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale, Ndërmarrja Komunale Plazh, Ndërmarrja Rruga, Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve si dhe Drejtoria e Buxhetit.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 461/prot.



Durrës, më 06.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 80 datë 28.06.2021 Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.46, datë 06.04.2012 “Për ndryshimin e VKB-së nr. 79, datë 10.05.2006 “Për miratimin e strukturave organizative dhe rregulloreve të brendshme të funksionimit të ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ROLAND NASTO *R.Nasto*

